

PRODHIMTARIA E USHQIMIT ORGANIK SI VEGËL PËR ZHVILLIM RURAL DHE KRIJIMIN E KUSHTEVE TË VOLITSHME SOCIALE DHE EKONOMIKE NË RAJONIN E PELLAGONISË

HYRJE

Republika e Maqedonisë posedon resurse dhe potencial për prodhimtari të ushqimit organik. Mënyra e prodhimit tek ne është ende e afërt me mënyrën e gjerë të prodhimtarisë, që do të thotë se konversioni drejt prodhimtarisë organike është më i thjeshtë në krahasim me prodhuesit e vendeve tjera të BE-së. Për fat të keq, për shkak të disa arsyeve, ky potencial ende nuk është përdorur.

Prodhimtaria organike tek ne në mënyrë më intensive fillon të zhvillohet në vitin 2005. Në vitin 2007, Qeveria e Republikës së Maqedonisë ka miratuar Strategjinë Kombëtare për Prodhimtari Bujqësore Organike (2008-2011), duke vendosur themelet për prezantimin dhe zhvillimin e prodhimtarisë organike bujqësore. Në vitin 2009, miratohet Ligji për prodhimtari organike bujqësore.

Me miratimin e Planit Kombëtar për Prodhimtari Organike 2013-2020 dhe Strategjisë Kombëtare për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2014-2020, projektohet rritje prej 4% deri në vitin 2020, por deri më tani vetëm 0,56% të tokave të përpunueshme në Maqedoni për momentin bëjnë pjesë në prodhimtarinë organike (OPM, 2018).

Zhvillimi i prodhimtarisë organike nga vetë fillimet, shënon një rritje, por nuk mjafton që të jetë i qëndrueshëm. Tregu i ushqimit organik nuk është mjaft i zhvilluar, sepse nuk janë të zhvilluar vetëdija dhe shprehitë për konsumim të ushqimit organik tek popullata jonë. Për të ngritur vetëdijen kombëtare për vlerën e ushqimit organik, si dhe promovimin e shenjave të reja kombëtare për produkte organike, që prej vitit 2010, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujit (MBPEU) fillon me realizimin e fushatës kombëtare për ngritjen e vetëdijes për konsumatorët për ushqim organik.

Por, të gjitha të dhënat statistikore dhe analizat tregojnë që janë të nevojshme aktivitete plotësuese nga ana e më tepër aktorëve për ngritjen e vetëdijes dhe informimit në lidhje me prodhimtarinë organike bujqësore. Masat e përbashkëta dhe aktivitetet, me kyçjen e gjitha palëve të përfshirë në mënyrë të ndryshme në sektorin e prodhimtarisë organike, do të kontribuojnë për rritjen e qëndrueshme të prodhimtarisë dhe tregut të ushqimit organik në Republikën e Maqedonisë. Në këtë dokument të shkurtë kemi dhënë pasqyrë e zbulimeve kryesore, drejtimeve dhe rekomandimeve për nxitjen dhe avancimin e këtij sektori të rëndësishëm, në Rajonin e Pellagonisë, por edhe në nivel të republikës.

ZBULIME KRYESORE

Zhvillimi i prodhimit organik nga vetë fillimet, shënon një rritje, por nuk mjafton që të jetë i qëndrueshëm. Që prej fillimit në vitin 2005, kur ka pasur 50 prodhues të regjistruar me sipërfaqe të plotë prej 266 hektarë tokë përpunuese, deri më vitin 2011 vazhdon me vazhdimësi të rritjes me 780 prodhues të regjistruar organik, dhe 6.581 hektarë sipërfaqe përpunuese. Por, pastaj vijnë vite të oscilimeve dhe uljes, ashtu që në vitin 2017 janë regjistruar 654 prodhues organik dhe 2.900 hektarë sipërfaqe përpunuese me prodhimtari organik (MBPEU, 2018). Megjithatë, në sistemin e bujqësisë organike përfshihen më tepër subjekte, dhe gjithashtu zgjerohen edhe kapacitetet e prodhimit.

Rajoni i Pellagonisë ofron kushte të volitshme të klimës dhe tokës për zhvillim të prodhimit organik bimorë dhe blegtorë. Sipas Regjistrimit për Prodhimtarin Organik (MBPEU, 2018) prej 654 subjekte organike në vend, si organike ose në ndryshim në rajonin e Pellagonisë veprojnë 63 ose rreth 10%, në 230 hektarë sipërfaqe bujqësore (prej të cilëve rreth 78% janë në kalim e sipër). Në prodhimtarinë blegtorale, në rajon më të përfaqësuar janë dhentë me 4000 kokë si dhe 1700 familje bletësh me prodhimtari rreth 10 tonelata mjaltë dhe produkte tjera të mjaltit.

Në lidhje me kornizën ligjore, imponohet nevojat për ndjekjen e rregullores së re evropiane për prodhimtari organik që do të fillojë me zbatimin prej 1 janarit 2021. Rregullorja parashikon një sërë lehtësimesh për prodhuesit, mes të cilave edhe certifikim në grup që do të mundësojë shpenzime më të ultë, ferma të përziera për prodhimtari organik dhe konvencionale, si dhe shmangie të kontroleve vjetore, gjegjësisht zbatimit të tyre çdo dy vite.

Për të ngritur vetëdijen kombëtare për vlerën e ushqimit organik, si dhe promovimin e shenjave të reja kombëtare për produkte organike, që prej vitit 2010, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujit (MBPEU) fillon me realizimin e fushatës kombëtare për ngritjen e vetëdijes për konsumatorët për ushqim organik.

Por, të gjitha të dhënat statistikore dhe analizat tregojnë që janë të nevojshme aktivitete plotësuese nga ana e më tepër aktorëve për ngritjen e vetëdijes dhe informimit në lidhje me prodhimtarinë organike bujqësore. Ka një nevojë për shoqërimin e prodhuesve organik dhe fushatë më agresive për produktet e tyre. Një qasje në këtë drejtim është sigurimi i stendave të veçanta në tregjet e gjelbër dhe vende të posaçme në dyqanet për të pasur më tepër dukje të produkteve organike për konsumatorët.

Një shembull të shkëlqyeshëm në këtë drejtim ka zhvilluar shoqata lokale "Slou Fud Bitola" nga Manastiri në partneritet me komunën e Manastirit dhe Ndërmarrjet Publike Tregje nga Manastiri, thjeshtë të quajtur "Tregu i Fermerëve". Gjatë vitit 2018, në hapësirë të rregulluar prej 120 m², në kuadër të tregut të gjelbër në Nova Bitola, që deri më tani nuk ishte i përdorur, çdo të shtunë të dytë prodhuesit e vegjël familjar të ushqimit të freskët, lokal dhe organik dhe produktet tradicionale të përpunuara i kanë ekspozuar dhe shitur produktet e tyre. Shoqata lokale kujdesej për promovimin e tregut dhe vetë programin për argëtim të konsumatorëve, me anë të organizimit të punëtorive edukative për ushqim, të synuar për më të rinjtë dhe gatues që në treg kanë përgatitur ushqim nga produktet që kanë mundur të blihen në treg. Ky shembull është një mundësi e shkëlqyeshme për promovim të prodhuesve të vegjël, të stimulohen për të certifikuar produktet e tyre si organike, si dhe të edukojnë konsumatorët për përfitimet dhe përparësitë e këtij ushqimi.

DREJTIME DHE REKOMANDIME

Në përputhje me përvojat e zbatuara deri më tani, komunikimi me prodhuesit, konsumatorët, shoqatat dhe personat ekspert në këtë fushë, në fillim duhet të bëhet **një analizë të thellë të sektorit** për të zbuluar problemet nga afër. Në koordinim me shumë shoqata, prodhues dhe aktorë tjerët në sektorin, i kemi përgatitur këto **propozime për përparimin e sektorit**, në Rajonin e Pellagonisë, por të zbatueshme edhe në nivel të republikës, për të cilat shpresojmë që disa do të zbatohet në periudhën vijuese:

1. Takime informative dhe edukim i prodhuesve

Ka një nevojë të madhe për **mbështetje të prodhuesve të vegjël** në kuptim të prodhimtarisë organike dhe certifikimit të produkteve të tyre.

Për të pasur shtrirje më të gjerë dhe informim të prodhuesve, duhet të organizohen **më tepër takime informative dhe punëtori edukative** me prodhuesit në bashkëpunim me njësitë rajonale të MBPEU dhe këshilltarëve të ANZHB-së. Këto punëtori, duhet të përfshijnë temat më poshtë:

- Përfitimet nga prodhimtaria organike;
- Masat që janë në dispozicion për ndryshim në prodhimtari organike;
- Procedura për certifikim;
- Teknika dhe teknologji të prodhimtarisë organike;
- Finalizimi, paketim, marketing të produkteve organike;
- Përdorimi i drejtë i shenjës kombëtare për ushqim organik;
- Gjetja e tregjeve dhe modeleve inovative për krijimin e kanaleve për shpërndarje, zinxhirë të shkurtë dhe shitje të drejtë;
- Bashkimi dhe veprimi i përbashkët i prodhuesve.

2. Lehtësimi i procedurave për regjistrim

Lehtësimi i procesit të regjistrimit dhe aprovimit të punës së objekteve prodhuese është një parakusht për zgjidhjen e shumë problemeve për ata që prodhojnë produkte të përpunuara nga produkte organike bimore dhe blegtove të prodhimtarisë primare, që do të kontribuojë për certifikimin e tyre më të lehtë si organike. Në këtë grup, do të bënin pjesë:

- Prodhues të vegjël të qumështit;
- Thertore të vogla dhe reparte për përpunimin e mishit;
- Përpunues të pemëve dhe perimeve organike;
- Bodrume vere të vogla;
- Mikro birrari;

- Mbledhës të frutave të egra, paje dhe kërpudha – për tharje dhe shkallë më të lartë të përpunimit dhe paketimin e tyre.

Lidhja e prodhuesve me konsumatorët

Duhet të bëhet mundësim i kushteve për mënyra të reja të **qasjes në tregun e prodhuesve organik** duke shkurtuar zinxhirin e shpërndarjes së ushqimit organik, me anë të stimulimit dhe inkurajimit të:

- Themelimit të tregjeve për prodhues organik, me mbështetje të drejt të komunave dhe rajoneve të planifikimit, në bashkëpunim me organizatat lokale, që do të paraqiten si koordinatorë të këtyre projekteve (duke ndjekur shembullin e suksesshëm të bashkëpunimit të “Slou Fud Bitola” me komunën Manastir dhe Ndërmarrjen Publike të Tregjeve nga Manastiri);
- Kooperativa për shitje dhe komunitete të konsumatorëve;
- Promovim dhe mbështetje të restoranteve – ofertë në menytë me shenja për “ushqim organik”;
- Shitje online, krijimi i platformave për reklamim, shpërndarje dhe shitje.

Promovimi dhe organizimi i fushatave

Duhet një fushatë e përbashkët për **përforcimin e vetëdijes për rëndësinë e ushqimit organik** dhe përfitimet na prodhimtaria e tyre dhe konsumimi, me anë të hapave vijues, si shembull:

- Mbështetje dhe përforcim të kapaciteteve të shoqatave të prodhuesve organik dhe federatave të tyre, organizata për ushqim dhe konsumatorë, shoqata për mbrojtjen e mjedisit jetësor, si dhe mundësimi i fondeve të posaçme për realizim të ideve të tyre për zgjedhjen e problemeve dhe çështjeve të caktuara;
- Përmirësim i transparencës së procesit të certifikimit dhe analiza e produkteve organike të pranishme në treg, me qëllim të mbrojtjes së konsumatorëve dhe krijimit të besimit ndaj prodhuesve vendor;
- Mbështetje dhe edukim të medieve, gazetarëve dhe shtëpive televizive, blogerë dhe përdorues të rrjeteve sociale, që kanë interes dhe do të trajtonin temën;
- Formim i aleancave me gatuesit – si promovuese të ushqimit lokal, sezonal dhe organik, me anë të organizimit të ngjarjeve dhe prezantimit në menytë në menza, kuzhina dhe restorante;
- Promovimi i kopshteve shkollore – si vegël për edukim dhe përforcim të vetëdijes tek gjeneratat më të reja për rëndësinë e prodhimtarisë organike dhe ushqimit organik.

KONKLUZION

Rritja e pjesës së prodhimitarisë bujqësore që përdor metoda të qëndrueshme organike të prodhimitarisë nuk është zgjedhje, por nevojë. Thjeshtë, nuk mund të vazhdojmë të prodhojmë ushqim në të ardhmen, pa mos u kujdesur për shëndetin e njeriut, tokën, ujin dhe llojllojshmërinë biologjike.

Sfidat janë të pranishme me ata dhe përballohem i çdo ditë. Nga pamundësia e furnizimit të farës së duhur, mungesa e thertoreve të vogla të regjistruar për therjen e kafshëve, mungesa e numrit të mjaftueshëm të konsulentëve për prodhimtari organike, sasi të vogla që pamundëson vendosjen jashtë shtetit, etj. Megjithatë, gjithnjë e më i madh është numri i aktorëve që punojnë në zgjidhjen e tyre.

Rajoni i Pellagonisë ofron kushte të volitshme për zhvillimin e prodhimitarisë organike, të atyre bimore, blegtove, bletare dhe përpunime. Prodhimtaria organike do të rritet nëse punojmë në edukimin e prodhuesve, konsulentëve dhe konsumatorëve. Të gjithë duhet të dinë përse të zgjedhin produkt organik para atyre konvencionale, sepse organiku është më i shtrenjtë dhe cilat janë përfitimet e këtij lloji të prodhimit. Drejtime tjera të nxitjes së sektorit janë lehtësimi i procedurave për themelimin dhe funksionimin e përpunuesve të vegjël të konsumatorëve dhe mënyrave të reja të promovimit të ushqimit organik. Duhet të përdoren shembujt e suksesshëm, si organizimi i "Tregut të Fermerëve" nga ana e Slou Fud Bitola" nga Manastiri në partneritet me Komunën e Manastirit dhe Ndërmarrjen Publike Tregje Manastir, si model të funksionon.

Masat e përbashkëta dhe aktivitetet, me kycjen e gjitha palëve të përfshirë në mënyrë të ndryshme në sektorin e prodhimitarisë organike, do të kontribuojnë për rritjen e qëndrueshme të prodhimitarisë dhe tregut të ushqimit organik në Republikën e Maqedonisë. Duhet të gjithë të punojmë që të përdorim potencialin që e posedojmë, por në fillim duhet të zhvillojmë kapacitetet tona për tejkalimin e pengesave dhe zhvillimin e gjithë sistemit nga prodhimtaria deri në konsumim.

BURIMET

MBPEU (2009) Ligjit për Prodhimtari Bujqësore Organike (Gazeta Zyrtare e RM, numër 146/2009)

MBPEU (2013) Plani Kombëtar për Prodhimtari Organike 2013-2020, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujit e Republikës së Maqedonisë, Shkup.

MBPEU (2013) Strategjia Kombëtare e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural 2014-2020, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujit e Republikës së Maqedonisë, Shkup.

MBPEU (2018) Gjendja me Prodhimtarinë Organike 2017, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujit e Republikës së Maqedonisë, Shkup.

MBPEU (2018) Regjistri i Prodhimtarisë Organike, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujit e Republikës së Maqedonisë, Shkup.

OPM (2018) Studim: Ushqimi Organik më afër Konsumatorëve, Organizata e Konsumatorëve e Republikës së Maqedonisë, Shkup

www.slowfood.mk

www.fondazione Slow Food.com/en/

INFORMACIONE PLOTËSUESE

Shoqata për Mbrojtje, Promovim dhe Edukim për Ushqim “Slou Fud Bitola” - Manastir

Nikolçe Nikollovski, kryetar

070 922 429

nikolce.n@slowfood.mk; info@slowfood.mk

www.slowfood.mk